



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data
29.03.2021

Lënda: Sjellje në vëmendje.

DREJTUAR: Të gjitha Bashkive

Nr. Protokoll
2564

PËR DIJENI: OSCE/ODIHR

Adresa: Hotel Mak Albania, kati I 1, Sheshi "Italia", Tiranë

Duke marrë në konsideratë raportet e para të depozituara nga monitoruesit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në pëmbushje të përgjegjësive të veta dhe me qëllimin për të përgatitur, zhvilluar dhe administruar zgjedhjet e datës 25 prill, në përputhje me standardet më të mira për zgjedhje të lira, të drejta dhe të ndershme, i bën apel të gjithë drejtuesve të institucioneve publike të tregojnë vetëpërbajtje e të pëmbushin detyrimet e tyre sipas Kodit Zgjedhor lidhur me zbatimin e nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar "Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore"

Gjithashtu referuar nenit 79, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar "Afishimi i materialeve propagandistike" kujdesuni që faqa juaj zyrtare e internetit të jetë e aksesueshme dhe funksionale sipas detyrimeve të përcaktuara në ligj.

Bashkëlidhur do të gjeni edhe udhëzimin nr. 6, datë 23 Mars 2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

Respektimi i dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe standarteve të kërkuara, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në standartet e procesit zgjedhor, si kusht kryesor për procesin integruar të vendit. Kjo tërheqje vëmendje t'u përcillet gjithashtu edhe organeve tuaja të varësisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CEBIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Mars 2021

Nr: 6

UDHËZIM

**PËR PËRDORIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE E EDUKUESE DHE
RREGULLAT PËR AFISHIMIN E TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “dh” e “n”, e 2, 78 pikat 1 e 10, dhe 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve të vendndodhjes së zyrave zgjedhore, kriteret për përdorimin e materialeve propagandistike/edukuese dhe përcaktimi i listës së sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë me vlerat maksimale për secilin prej tyre.
2. Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e rregullave që do të ndiqen nga subjektet zgjedhore në përdorimin e materialeve propagandistike, caktimin e vendeve publike të lejuara për afishimin e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe monitorimin e zbatimit të këtyre rregullave nga kryetarët e bashkive dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë udhëzim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:



Data: 23 Mars 2021
Nr. 6

Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore

1. "Materiale propagandistike statike" kanë të njëjtin kuptim si në vendimin nr. 12, datë 30.12.2020, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e rregullave të veprimtarisë së policisë së shtetit në shërbim të zgjedhjeve".
2. "Materiale edukuese zgjedhore" janë materialet që i shërbejnë edukimit të zgjedhësve lidhur me të drejtat e tyre, procedurat e regjistrimit dhe mënyrës së votimit dhe aspekte të tjera të parashikuara në Kodin Zgjedhor.
3. "Zyra zgjedhore" janë mjediset/zyrat që përdoren nga subjektet zgjedhore apo kandidatët e tyre për qëllime të fushatës zgjedhore.

Neni 3

Caktimi i vendeve për afishimin e materialeve propagandistike

1. Kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, jo më vonë se 35 (tridhjetë e pesë) ditë para datës së zgjedhjeve, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore. Materialet propagandistike zgjedhore lejohet të afishohen deri në një distancë prej 5 (pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve. Me mbarimin e fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore marrin masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike.
2. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.
3. Ndalohet vendosja e materialeve propagandistike në mjete që operojnë në transportin publik.
4. Vendet e caktuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të jenë në mjedise që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme që të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të mund të paraqesin materialet propagandistike, programet e tyre zgjedhore dhe/ose mesazhet zgjedhore.
5. Vendet publike në territorin e bashkisë të dedikuara për afishimin e materialeve propagandistike duhet t'u shpërndahen subjekteve zgjedhore në mënyrë proporcionale duke shmangur dhënien e përparësisë për ndonjë prej subjekteve zgjedhore.
6. Kryetarët e bashkive duhet të marrin masa për të mos lejuar apo të heqin menjëherë çdo material statik, përfshirë posterat dhe flamujt nga çdo vendndodhje tjetër ku ato konstatohen që nuk janë vendosur në përputhje me kriteret e këtij udhëzimi.



7. Vendimi i kryetarit të bashkisë për caktimin e vendeve për afishimin e materialeve propagandistike bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit dhe një kopje e tij i njoftohet Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet brenda 24 orësh nga miratimi i tij. Vendimet e marra nga kryetarët e bashkive përpara miratimit të këtij udhëzimi rishikohen në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.
8. Subjekteve zgjedhore iu lejohe të afishojnë materialet propagandistike vetëm në vendet e përcaktuara nga kryetari i bashkisë, sipas këtij neni, dhe marrin masa për heqjen e tyre me përfundimin e fushatës së zgjedhjeve.
9. Ngarkohet policia e shtetit për zbatimin e pikës 3 të këtij neni.

Neni 4

Caktimi i vendeve për afishimin e materialeve edukuese zgjedhore

1. Afishimi i materialeve edukuese zgjedhore, në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së) ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar, bëhet në vendet e caktuara nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
2. Vendi i afishimit të materialeve edukuese dhe informuese, sipas pikës 1 të këtij neni, si rregull, duhet të jetë me akses të lartë për publikun dhe hapësirë të bollshme për afishimin e të gjitha materialeve edukuese.

Neni 5

Zyrat zgjedhore

1. Zyrat zgjedhore të subjekteve zgjedhore mund të hapen në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve.
2. Subjekti zgjedhor njofton me shkrim Kryetarin e Bashkisë përkatëse dhe vë në dijeni KQZ-në për hapjen e zyrave zgjedhore dhe për adresat e sakta të tyre, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve.
3. Administrata e bashkisë përkatëse, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit, bën verifikimin e vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të këtij udhëzimi për afishimin e materialeve propagandistike.
4. Policia bashkiake garanton zbatimin e detyrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni me kërkesë të KQZ-së.

Neni 6



Përdorimi i materialeve dhe sendeve të lejuara për fushatë

Subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre lejohen të ofrojnë sende dhe materiale të printuara fushate kur vlera e tyre është më e vogël se 500 (pesëqind) lekë për send ose material. Lista e këtyre sendeve dhe materialeve paraqitet në Shtojcën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 7

Organet që ngarkohen me zbatimin e Udhëzimit

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen kryetarët e bashkive, subjektet zgjedhore, punonjësit e policisë bashkiake dhe të policisë së shtetit, si dhe monitoruesit e caktuar nga KQZ-ja. Moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, përbën kundërvajtje administrative sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor.

Neni 8

Shfuqizim

Udhëzimi nr.1, datë 31.05.2017, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", shfuqizohet.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



SHTOJCË

Lista e materialeve të printuara dhe sendeve të lejuara për fushatë zgjedhore me vlerë më të vogël së 500 lekë		
Nr.	Emërtimi	
I MATERIALE TË PRINTUARA		
1	Poster imazhi, logo përkatësie politike dhe mesazhi partia/kandidati	
2	Postera informues/edukues për programin e partisë, letër me lustër me ngjyra	
3	Fletushka për shpërndarje e mesazheve dhe premtimeve elektorale që përcjell partia/kandidati	
4	Fletëpalosje për mesazhin dhe premtimet elektorale që përcjell partia/kandidati	
5	Kartolina mesazhi/informacioni për partinë/kandidatin	
6	Kartëvizita zgjedhore për përhapjen e shpejtë të mesazhit elektorial ose kujtesë	
7	Zarfe të personalizuar që përmbajnë letër me mesazhe/ programe që përcjell partia/kandidati	
8	Broshura të ndryshme me programe të partisë/kandidatit	
9	Dosje të stampuara me logon e partisë/emërtimin e partisë/emrin e kandidatit	
10	Simbole ngjitëse stickers me logo	
II SENDE/MATERIALE TË LEJUARA PËR FUSHATË		
1	Kapele të stampuar, me logo të partisë, slogan të partisë/kandidatit	
2	Bluza T-shirt stampuar, me logon dhe slogan të partisë/kandidatit	
3	Stilolapsa me logo të partisë ose slllogan	
4	Bllloqe agjende me logo/slllogan të printuar	



Data: 23 Mars 2021

Nr. 6

Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore

5

5	Çanta të stampuara me logo dhe sloganin	
6	Maska me logon e partisë/ose imazhin e kandidatit	
7	Byzylykë me logon e partisë/ emrin e kandidatit	
8	Flamuj me dimensione të vogla me emrin dhe logon e partisë	
9	Afishe ngjitëse version rrethor/katror me përmasa të ndryshme	
10	Etiketa të stampuara me logo apo slogan të partisë/kandidatit	
11	Rripa për Badges/etiketash	
12	Tullumbace të stampuara me logon/mesazhin e partisë/kandidatit	
13	Çadra të stampuara me logo	
14	Spila/Kapëse/karficë/bagdes me simbole	
15	Stema/butona të stampuara me logo	
16	Magnet me logo	
17	Mbajtëse çelësash me logo	
18	Zhurmuere, vuvuzela etj	
19	Covera/adezive të ndryshme në dimensione të vogla	
20	Mbulesa tavoline të stampuara me logo ose mesazhe	

